




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DELVINË

# Paketa Fiskale e vitit 2025





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DELVINË**  
**KËSHILLI**  
**PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**  
**NË BASHKINË E DELVINËS**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139 dt 17.12.2015 . **“Për Vetqeverisjen Vendore”** , ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 **“Për Sistemin e Taksave Vendore”** i ndryshuar, ligjit Nr. 9920 dt 19.05.2008 **“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”** i ndryshuar, ligjit Nr. 9975 dt 28.07.2008 **“Për Taksat Kombëtare”** i ndryshuar, Ligji Nr 106/2017 date 30.11.2017” **Mbi taksen e pasurise**” dhe VKM nr 132 date 7.3.2018 **“Mbi metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se palujteshme-Ndertesë”**, ligjit Nr. 9723 **“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”** i ndryshuar, ligji Nr. 107/2014 **“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit “** i ndryshuar, ligji Nr. 10465 dt 29.09.2011 **“Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”** i ndryshuar, ligji Nr. 8378 dt 22.07.1998 **“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”** i ndryshuar, Ligji Nr. 9385 dt 4.5.2005 i ndryshuar, **“Per Pyjet dhe Sherbimin Pyjor”** i ndryshuar, Ligji Nr. 9693 dt 19.03.2007 **“Per Fondin Kullor”** dhe VKM Nr. 632 dt. 11.6.2009 **“Per miratimin e tarifave te perdorimin të kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje bari”**, Ligji Nr. 10120 dt 23.4.2009 **“ Per mbrojtjen e fondit te bimeve eterovajore etanifere natyrore”** , VKM Nr 391 dt 21.6.2006 **“Per Percaktimin e tarifave te kullotave e pyjeve”** i ndryshuar, VKM NR 1064 date 22.12.2010, legjislacionit të aplikueshëm në fuqi, aktet nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, bazuar në relacionin e hartuar nga grupi i punës për përgatitjen e Paketës Fiskale, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak:

**TË VENDOSI:**

- 1. Miratimin e Paketës Fiskale të taksave dhe tarifave vendore, për Bashkinë e Delvinës, të ndara e të strukturuar për ç’do njësi administrative, si më poshtë vijon:*

## **PËRKUFIZIME:**

*Paketa Fiskale përcakton nivelin e taksave dhe tarifave vendore, procedurat si dhe strukturat e ngarkuara të Bashkisë Delvinë për vjeljen e tyre.*

*“Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e shtetit apo në buxhetin e qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik.*

*“Tarifë” janë të ardhura që krijohen nga njëësia e qeverisjes vendore për shërbimet publike që afron, të drejtën në përdorimin e pronave publike vendore, dhënien e liçensave, te lejeve, autorizimeve dhe të dokumentave të ndryshme, për të cilat ato kanë autoritet të plotë.*

## **A. TAKSAT VENDORE**

### **A.1 TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL**

Shkalla tatimore do të jetë:

E përcaktuar nga Paketa Fiskale dhe Buxhetore e Qeverisë për vitin 2025 për çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, u nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë kre. Pagesa do të kryhet në katër këste brenda datave 20 Prill, 20 Korrik, 20 Tetor dhe 20 Dhjetor të çdo viti. Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Për administrimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël është ngarkuar Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë. Të ardhurat e realizuara prej tij do të derdhen për llogari të Bashkisë çdo datë 10 te muajit pasardhës. Shpërblimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë do të jetë 1% e shumës së derdhur për llogari të Bashkisë.

### **A.2 TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME**

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasuritë e paluajtshme përfshihen:

- ❖ *Taksa mbi ndërtesat*
- ❖ *Taksa mbi tokën bujqësore*
- ❖ *Taksa mbi truallin*

### A.2.1 TAKSA MBI NDËRTE SAT

**Baza e taksës** mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës që llogaritet në përputhje me metodologjine dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr.106/2017 datë 30.11.2017, me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 132 datë 7.3.2018. Sipërfaqia në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi dhe në rastin e mungesës së dokumentacionit, përdoruesi i ndërtesës bën një vetdëklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa, inspektorët e taksës se pasurisë bëjnë verifikime në terren.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave njih si dokumentacion një nga dokumentat e mëposhtme:

- **Vërtetimin e pronësisë**
- **Vendimet e komisionit të kthimit të pronave**
- **Vendimet e privatizimit**
- **Vetëdëklarimin**
- **Vendimet e komisionit të verifikimit të pasurive të paluajtëshme**
- **Ndërtesat që janë në proces legalizimi**

*\*Në mungesë të dokumentacioneve të mësipërme të kryhet vlerësim alternativ për një sipërfaqe mesatare prej 100 m<sup>2</sup>.\**

**Shkalla e taksës** mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Duke ju referuar Aneksit nr.1 të VKM nr 132 date 7.3.2018 “**Mbi metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtëshme-Ndertesat**”, çmimi mesatar referues i shitëblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllime banimi, për bashkinë e Delvinës dhe zonave që janë në juridiksion është **26.750 leke/m<sup>2</sup>** sipërfaqe shfrytëzimi.

**Konkretisht sipas referimit të Aneksit nr. 2 të VKM së mësipërme, për Bashkinë Delvinë, kemi këto vlera të përlllogaritura për ndërtesa, shtëpi banimi dhe për ato që nuk shërbejnë si të tilla:**

## Për Njësinë Administrative Delvinë

| Nr | Emërtimet   | Çmimi Lekë/m <sup>2</sup>                   |
|----|---|---|
| 1  | Për ndërtesa që shfrytëzohen për banim.<br>llogaritja $0.05 \% * 26.750$  | <b>13.<sup>375</sup> lekë/m<sup>2</sup></b> |
| 2  | Shfrytëzohen për veprimtari ekonomike- tregëti e shërbime.<br>llogaritja $(1.5 * 26.750) * .02 \%$  | <b>80.<sup>25</sup> lekë/m<sup>2</sup></b>  |
| 3  | Parkim i mbuluar dhe bodrume.<br>(llogaritja $(70 \% * 26.750) * 0.2 \%$ )  | <b>37.<sup>45</sup> lekë/m<sup>2</sup></b>  |
| 4  | Parkim i hapur.<br>llogaritja $(30 \% * 26.750) * 0.2 \%$   | <b>16.<sup>05</sup> lekë/m<sup>2</sup></b>  |
| 5  | Objekte për veprimtari industriale, prodhim, përpunim, magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrika, depo etj. të ngjashme me to.<br>llogaritja $(50 \% * 26.750) * 0.2 \%$  | <b>26.<sup>75</sup> lekë/m<sup>2</sup></b>  |
| 6  | Objekte që përdoren për bujqësi dhe blektori, ose veprimtari mbështetëse si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blektorale, me përjashtim të përpunimit ushqimor.<br>llogaritja $(30 \% * 26.750) * 0.2 \%$ | <b>16.<sup>05</sup> lekë/m<sup>2</sup></b>  |

## Për Njësinë Administrative Vergo

Sipas pikës 'dh' të Aneksit nr 2 të VKM nr 132 datë 7.3.2018, Njësia Administrative VERGO përfiton reduktim të çmimit të referencës deri 35% (tridhjetë e pesë), përjashtuar zonat rezidenciale.

| Nr | Emërtimet   | Çmimi Lekë/m <sup>2</sup>                  |
|----|---|--|
| 1  | Ndërtesa që shfrytëzohen për banim.<br>llogaritja $0.05 \% * (26.750 - 26.750 * 35 \%)$   | <b>8.<sup>69</sup> lekë/m<sup>2</sup></b>  |
| 2  | Shfrytëzohen për veprimtari ekonomike- tregëti e shërbime.<br>llogaritja $1.5 * (17.387.5 * .02 \%)$  | <b>52.<sup>16</sup> lekë/m<sup>2</sup></b> |
| 3  | Parkim i mbuluar dhe bodrume.<br>(llogaritja $70 \% * 17.387.5 * 0.2 \%$ )  | <b>24.<sup>34</sup> lekë/m<sup>2</sup></b> |
| 4  | Parkim i hapur.<br>llogaritja $30 \% * 17.387.5 * 0.2 \%$   | <b>10.<sup>43</sup> lekë/m<sup>2</sup></b> |
| 5  | Objekte për veprimtari industriale, prodhim, përpunim, magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrika, depo etj. të ngjashme me to.<br>llogaritja $50 \% * 17.387.5 * 0.2 \%$  | <b>17.<sup>38</sup> lekë/m<sup>2</sup></b> |
| 6  | Objekte që përdoren për bujqësi dhe blektori, ose veprimtari mbështetëse si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blektorale, me përjashtim të përpunimit ushqimor.<br>llogaritja $30 \% * 17.387.5 * 0.2 \%$ | <b>10.<sup>43</sup> lekë/m<sup>2</sup></b> |

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj ose edhe me afate më të gjata, në vartësi të kategorisë së taksapaguesit.

Në aneksin 2 të VKM citohet se *ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” i ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 % (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.*

Kjo taksë vilet nëpërmjet Agjentit Tatimor të përzgjedhur, që është **“Ujësjellës Kanalizime Sha”** duke u votuar së bashku me Paketën Fiskale në Këshillin Bashkiak. Duhet thënë se nga agjenti tatimor vilet taksa e ndërtesës dhe tarifat e shërbimit publik, vetëm për familjarët që kanë kontratë shërbimi me ndërmarrjen e **Ujësjellës-Kanalizimeve**, ndërsa familjet të cilat janë jashtë kontratave me Ujësjellësin, janë objekt i punës së Drejtorisë Taksave dhe Tarifave. Marrëdhëniet me Agjentin Tatimor rregullohen nëpërmjet kontratës së posaçme. Agjenti Tatimor shpërblehet në masën **5 %** të shumës së arkëtuar, në llogari të buxhetit të Bashkisë.

### **Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:**

- a) pronat e shtetit dhe të njërive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;*
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;*
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;*
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;*
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;*
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;*
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;*
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;*
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;*
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.*

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Taksës mbi ndërtesat dhe administrimin e saj, është Drejtorisë Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Delvinë ose agjenti tatimor i caktuar nëpërmjet votimit në Këshillin Bashkiak.

## A.2.2 TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Për taksën e tokës është marrë parasysh klasifikimi i rrethit të Delvinës në kollonën ( 2 ) të ligjit Nr. 9632 dt. 30.10.2006 si dhe vlera e tokës sipas kategorisë së saj.

| Nr | KATEGORIA E TOKËS/VENDET    | NJËSIA      | 2025         |
|----|-----------------------------|-------------|--------------|
| 1  | Delvinë                     | Lekë/ha/vit | <b>2.557</b> |
| 2  | Shamar                      | Lekë/ha/vit | <b>2.557</b> |
| 3  | Stjar                       | Lekë/ha/vit | <b>2.557</b> |
| 4  | Vane                        | Lekë/ha/vit | <b>2.310</b> |
| 5  | Rusan                       | Lekë/ha/vit | <b>2.310</b> |
| 6  | Vllahat                     | Lekë/ha/vit | <b>2.310</b> |
| 7  | Bamatat                     | Lekë/ha/vit | <b>2.310</b> |
| 8  | Sopot                       | Lekë/ha/vit | <b>1.624</b> |
| 9  | Lefterhor                   | Lekë/ha/vit | <b>1.624</b> |
| 10 | Kakodhiq                    | Lekë/ha/vit | <b>1.624</b> |
| 11 | Blerimas                    | Lekë/ha/vit | <b>1.800</b> |
| 12 | Njesia administrative Vergo | Lekë/ha/vit | <b>2.300</b> |

Baza e taksës së tokës është sipërfaqja në hektar e tokës në pronësi ose në përdorim nga taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë dhe në rast të mungesës së dokumentacionit, përdoruesi i tokës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Afati i vjeljes së kësaj takse është gjithëvjetor.

Niveli i taksës është caktuar në lekë/ha mesatarisht sipas klasifikimit të zonës bujqësore në fshat, në pamundësi realizimi për çdo individ, në mungesë të regjistrave të bonitetit të ndarjes së tokës bujqësore të ish NB-ve dhe ish kooperativave bujqësore.

***Taksat janë të llogaritura për çdo fshat sipas Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, mbështetur në klasifikimin dhe kategoritë të tokave bujqësore nga strukturat e M.B&U. si dhe në proces verbalet e mbajtura.***

Përfshihen nga Taksa mbi tokën bujqësore sipërfaqet që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vjetët e para nga çasti i mbjelljes.

Taksa e tokës bujqësore mbledhet me Agjent Tatimor ose ndiqet direkt nga strukturat e bashkisë. Agjenti Tatimor shpërblehet në masën 5 % të shumës së mbledhur dhe arkëtuar për llogari të buxhetit të Bashkisë. Agjenti tatimor përzgjidhet nga Kryetari i Bashkisë dhe marrdhëniet me të rregullohen nëpërmjet kontratës së posaçme.

### A.2.3 TAKSA MBI TRUALLIN

Me "Truall", nënkuptojmë një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m<sup>2</sup>, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e të cilës ndodhet prona e taksueshme.

**Nivelet e taksës së truallit (jo hapësirë publike) janë:**

|   | <b>Taksë Truall</b>                     | <b>Njësia</b>            | <b>2025</b> |
|---|---|--------------------------|-------------|
| 1 | Truall për qëllime banimi nga individët | Lekë/m <sup>2</sup> /vit | <b>0.42</b> |
| 2 | Truall për qëllime biznesi              | Lekë/m <sup>2</sup> /vit | <b>18</b>   |

### A.3 TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Baza e taksës së fjetjes në hotel, është numri i netëve të qëndrimit në hotel për person. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. Janë subjekt i Taksës të gjithë veprimtaritë që japin strehim kundrejt pagesës si hotelet, motelet, stabilimentet turistike, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizmi familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim, pavarësisht emërimit që mban.

| <b>Lloji i Taksës</b>  | <b>Njësia e matjes</b> | <b>Niveli i taksës 2025</b> |
|--|------------------------|-----------------------------|
| Taksë fjetje për hotelet me 4-5 yje  | Lekë/natë fjetjeje     | <b>105</b>                  |
| Hotelet 3 dhe më pak yje – bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas ligjit për turizmin | Lekë/natë fjetjeje     | <b>35</b>                   |

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është e Drejtorisë Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Delvinë. **Afati i fundit të pagesës do të jetë data 31 Dhjetor.**



#### A.4 TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

| <b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet</b>  | Vlera                        | <b>2025</b> |
|--|------------------------------|-------------|
| a). Për banesat  | Vlerë investimi              | <b>1%</b>   |
| b). Për objekte administrative dhe njësi shërbimi  | Vlerë investimi              | <b>2%</b>   |
| c). Ndërtesa në proces legalizimi  | Vlerë investimi              | <b>0.5%</b> |
| d). Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi ose njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industris apo përdorim publik. | Çmimi shitjes/m <sup>2</sup> | <b>4%</b>   |
| e). Projekte të infrastrukturës  |                              |             |
| • Ndikim në infrastrukturë ndertime të reja  | Vlerë investimi              | <b>0.1%</b> |

Çmimi i shitjes për m<sup>2</sup> bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohen çdo vit.

Objekte të infrastrukturës do të konsiderohen të gjitha llojet e investimeve që mund të kryhen në ndërtim objektiv infrastrukturor, si ndërtim apo rikonstruksione rrugësh, kanalizimesh, linjash etj. Përfshihen për objektet e infrastrukturës për ndërtime të rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe paisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 % e vlerës së investimit por jo më shumë se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

*Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.*

Detyrimi për taksën i takon investitorit.

**Struktura e ngarkuar për administrimin e saj është Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë Taksave dhe Tarifave.**

## A.5 TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtëshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtëshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë.

|   | <b>Kategoria</b>                 | <b>Njësia</b>       | <b>2024</b> | <b>2025</b> |
|---|----------------------------------|---------------------|-------------|-------------|
| 1 | Ndërtesa banimi                  | lekë/m <sup>2</sup> | 100         | 100         |
| 2 | Ndërtesa për tregti dhe shërbime | lekë/m <sup>2</sup> | 300         | 300         |
| 3 | Ndërtesa të tjera                | lekë/m <sup>2</sup> | 200         | 200         |
| 4 | Për truallin apo tokën bujqësore | Vlerë shitje        | 2%          | 2%          |

Vjelja e kësaj takse bëhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila në rolin e agjentit të taksave përfiton **3%** të shumës së arkëtuar.

**Struktura përgjegjëse për akt-rakordimin me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë është Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimi të Territorit në Bashkinë Delvinë.**

## A.6 TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve, shërbimit të transportit të mallrave ose subjekte të tjera të shërbimit të cilat nuk kanë mundësi praktike për vendosjen e saj.

Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtme:

## Aneksi 7

## TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE

| Nr          | LLOJET E TABELAVE  | Nj/matëse                 | Bashki Kat.I              | Bashki Kat.II   | Bashki Kat.III                |
|-------------|--|---------------------------|---------------------------|---|-------------------------------|
| <b>I.</b>   | <b>Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)</b> |                           |                           |   |                               |
| <b>a</b>    | <i>deri në 2 m<sup>2</sup></i>   | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 0                         | 0   | 0                             |
| <b>b</b>    | <i>-mbi 2 m<sup>2</sup> deri 10 m<sup>2</sup></i>  |                           |                           |   |                               |
|             | <i>-e thjeshtë (pa ndriçim)</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 15 000                    | 10 000  | 7 000                         |
|             | <i>-me ndriçim të thjeshtë</i>   | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 20 000                    | 15 000  | 11 500                        |
|             | <i>-elektronike</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 35 000                    | 20 000  | 15 000                        |
| <b>c</b>    | <i>mbi 10 m<sup>2</sup> deri 20 m<sup>2</sup></i>  |                           |                           |   |                               |
|             | <i>-e thjeshtë (pa ndriçim)</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 12 750                    | 8 500   | 5 950                         |
|             | <i>-me ndriçim të thjeshtë</i>   | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 17 000                    | 12 750  | 9 775                         |
|             | <i>-elektronike</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 29 750                    | 17 000  | 12 750                        |
| <b>ç</b>    | <i>mbi 20 m<sup>2</sup> deri 40 m<sup>2</sup></i>  |                           |                           |   |                               |
|             | <i>-e thjeshtë (pa ndriçim)</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 8 250                     | 5 500   | 3 850                         |
|             | <i>-me ndriçim të thjeshtë</i>   | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 11 000                    | 8 250   | 6 325                         |
|             | <i>-elektronike</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 19 250                    | 11 000  | 8 250                         |
| <b>d</b>    | <i>mbi 40 m<sup>2</sup></i>  |                           |                           |   |                               |
|             | <i>-e thjeshtë (pa ndriçim)</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 6 000                     | 4 000   | 2 800                         |
|             | <i>-me ndriçim të thjeshtë</i>   | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 8 000                     | 6 000   | 4 600                         |
|             | <i>-elektronike</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 14 000                    | 8 000   | 6 000                         |
| <b>II.</b>  | <b>Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim</b>   |                           |                           |   |                               |
|             | <i>-Tabela identifikuese</i>   | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 120                       | 120   | 120                           |
| <b>III.</b> | <b>Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m<sup>2</sup></b>  |                           | <b>Bashkia<br/>Tiranë</b> | <b>Bashkia<br/>Durrës dhe<br/>gjithë bashkitë<br/>e tjera të Kat.II</b> | <b>Bashkitë e<br/>Kat.III</b> |
|             | <i>-e thjeshtë (me/pa ndriçim)</i>   | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 45 000                    | 22 500  | 13 500                        |
|             | <i>-Elektronike</i>  | lekë/m <sup>2</sup> /vit  | 90 000                    | 45 000  | 27 000                        |
| <b>IV.</b>  | <b>Tabela ne funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.</b>  |                           |                           |   |                               |
|             | <i>-të të gjitha llojeve dhe përmasave</i>   | lekë/m <sup>2</sup> /ditë | 1 000                     | 1 000   | 1 000                         |

## Shënim: Bashkitë sipas kategorive ndahen:

Kategoria I: Tiranë, Durrës

Kategoria II: Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastër, Lezhë, Krujë.

Kategoria III: Të gjithë bashkitë e tjera

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m<sup>2</sup>, shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m<sup>2</sup> do t'i shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m<sup>2</sup> të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh., një tabelë të thjeshtë 15 m<sup>2</sup>, shuma e taksës vetore do llogaritet: (10 m<sup>2</sup> x 15 000 lekë) + (5 m<sup>2</sup> x 12 750 lekë) = 150 000 + 63 750 = 213 750 lekë në vit (ose 17 812 lekë/muaj). E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m<sup>2</sup> dhe mbi 40 m<sup>2</sup>. Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë. Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m<sup>2</sup>, do të konsiderohet sikur është 35 m<sup>2</sup> dhe shuma e tak llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m<sup>2</sup>. Ne kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje jo ballore, në tarraca, lozhë, ballkone, në pjesë të shtyllës shtylla etj në kanë përmbajtje me qëllime reklamimi nër vete ose të tretë

1 - Tabelat kategorizohen në:

- i) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.
- ii) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.
- iii) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.
- iv) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

2-. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj. për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

3-. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga germa të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasadë të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zenë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe germa, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori table. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një table identifikuese, përveç

atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda

territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelle.

Ngarkohet Sektori i Planifikimit të Territorit të lëshojë lejet për vendosjen e reklamave dhe informon për çdo leje të dhënë, Juristin e Bashkisë për lidhjen e kontratës dhe Drejtorisë Taksave dhe Tarifave .

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është e Drejtorisë Taksave dhe Tarifave.

### **Detyrimi për Taksën e tabelës është vjetor.**

Afati i pagesës është deri më 31 Gusht, ndërsa për subjektet e reja në momentit e regjistrimit.

## **ANKIMI**

|  |
|--|
| Çdo taksapagues ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën se si janë vlerësuar detyrimet e tij, të kërkojë rimbursime si dhe të apelojë kundër çdo veprimi ose mosveprimi nga struktura përkatëse e tatim taksave në Bashki.  |
| Ankimi paraqitet me shkrim pranë Kryetarit të Bashkisë brenda 30 ditëve nga marrja dijani për aktin administrative dhe përmban:  |
| a) emrin , adresën dhe NIPT-in e apeluesit,  |
| b) vitin tatimor për të cilën bëhet ankimi,  |
| c) natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt i apelimit,  |
| d) baza ku mbështetet apelimi.   |
| Subjekti duhet të përmbushë kërkesat e ligjit për parapagimin e detyrimeve përpara depozitimit të ankimit administrativ.   |
| Procedurat e apelimit dhe procedurat e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në Ligjin nr 9920 date 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të tij. Kryetari i Bashkisë shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. |
| Kundër vendimit të Kryetarit të Bashkisë , subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatë, kjo brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes në dijani për vendimin e mësipërm.  |

## **B. TARIFAT VENDORE**

### **B.1.1 TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET E BIZNESIT TË VOGËL.**

Niveli i tarifave të pastrimit, ndriçim dhe gjelbërimit është përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

| <b>Nr</b> | <b>Kategoria</b>   | <b>Njësia</b>  | <b>2025</b> |
|-----------|--|----------------|-------------|
| <b>1</b>  | <b>Për subjekte me sipërfaqe lokale</b>                              |                |             |
|           | Subjekte të tregtisë me pakicë me sip. <b>Deri 30 m<sup>2</sup></b>  | lekë/vit       | 6 000       |
|           | Subjekte të tregtisë me pakicë me sip. <b>31 - 50 m<sup>2</sup></b>  | lekë/vit       | 7 000       |
|           | Subjekte të tregtisë me pakicë me sip. <b>51 - 100 m<sup>2</sup></b> | lekë/vit       | 10 000      |
|           | Subjekte të tregtisë me pakicë me sip. <b>mbi 100 m<sup>2</sup></b>  | lekë/vit       | 14 000      |
|           | Subjekte të ndryshme shërbimi  | lekë/vit       | 9 000       |
|           | Subjekte prodhimi të ndryshme  | lekë/vit       | 12 000      |
|           | Subjekte të profesionit të lirë                                      | lekë/vit       | 14 000      |
|           | Subjekte ambulante (te tregjet)                                      | lekë/vit       | 0           |
|           | Kioska të ndryshme   | lekë/vit       | 0           |
|           | Subjekte që administrojnë vetëm hotele dhe turizëm familjar          | lekë/dhome/vit | 500         |
|           | Komplekse hoteliere (hotel, bar, restorant)                          | lekë/dhome/vit | 5 000       |
|           | Apartamente të dhëna me qira për pushues                             | lekë/vit/ap.   | 3 000       |
| <b>2</b>  | <b>Transporti</b>  |                |             |
|           | <b>Transport pasagjerësh</b>   |                |             |
|           | ➤ Automjete deri në 5 vende  | lekë/vit       | 3 000       |
|           | ➤ Automjete 6 deri në 9 vende  | lekë/vit       | 5 000       |
|           | ➤ Automjete 10 deri në 25 vende                                      | lekë/vit       | 6 000       |

|  |                                 |          |       |
|--|---------------------------------|----------|-------|
|  | ➤ Automjete 26 deri në 42 vende | lekë/vit | 7 000 |
|  | ➤ Automjete mbi 42 vende        | lekë/vit | 7 500 |
|  | <b>Transport mallrash</b>       |          |       |
|  | ➤ Automjete deri në 2 ton       | lekë/vit | 3 000 |
|  | ➤ Automjete 2 deri në 5 ton     | lekë/vit | 5 000 |
|  | ➤ Automjete 5.1 deri në 10 ton  | lekë/vit | 6 000 |
|  | ➤ Automjete 10.1 deri në 16 ton | lekë/vit | 7 000 |
|  | ➤ Automjete mbi 16 ton          | lekë/vit | 9 000 |

Tarifa e shërbimeve publike është vjetore dhe do të llogaritet për çdo muaj të punuar, përjashtohen nga ky rregull subjektet hoteliere, detyrimi i tyre do të jetë sipas vlerës në tabelën e mësipërme.

**Afati i pagesës do të jetë jo më vonë se data 31 Gusht.**

**Për Njësinë Administrative Vergo vlerat e mësipërme të tarifave të shërbimit publik janë me 50 % të maturimit.**

#### **B.1.2 TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTE TË BIZNESIT TË MADH**

| <b>Nr</b> | <b>Kategoria</b>                        | <b>Njësia</b> | <b>2025</b> |
|-----------|---|---------------|-------------|
| 1         | Institucionet Shtetërore                | lekë/vit      | 60 000      |
| 2         | Shoqëritë e ndërtimit                   | lekë/vit      | 100 000     |
| 3         | Shoqëritë tregtare, prodhuese, shërbimi | lekë/vit      | 70 000      |
| 4         | Supermarketet                           | lekë/vit      | 100 000     |
| 5         | Filiale të tjera të SH.A. - ve          | lekë/vit      | 60 000      |
| 6         | Për Bankat                              | lekë/vit      | 100 000     |
| 7         | Për Komisiariatit e Policisë            | leke/viti     | 30 000      |

Subjektet e biznesit të madh që operojnë në territorin në juridiksion të Bashkisë Delvinë por që selinë e tyre e kanë jashtë këtij territori, do të paguajnë të njëjtin nivel tarife me subjektet që e kanë

selinë në territorin e Bashkisë. Detyrimi për tarifën do të llogaritet për kohën e kryerjes së aktivitetit.

**Afati i pagesës do të jetë data 31 Gusht.**

*Bashkia për debitorët problematikë dhe në shuma të mëdha, mund të delegojë, me miratim të këshillit Bashkiak, si agjent tatimorë të jashtëm, subjekte të liçensuara, duke përfituar jo më shumë se 10% të shumës së arkëtimit në buxhetin e Bashkisë.*

**B.1.3 TARIFA PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRESIMIN E MJEDISIT**

*( Neni 17, Ligji 68/2017 “Për Financat e Vetë qeverisjes Vendore” ;Ligji Nr10 431 datë 09.06.2011 (Për Mbrojtjen e Mjedisit).*

Të ardhurat e mbledhura nga tarifat mjedisore do të investohen në bazë të një plani zhvillimor nga Bashkia Delvinë dhe do të përfshijnë masa për mbrojtjen e tokës, të ujërave, ajrit, pyjeve, klimës, ekosistemeve, peisazhit natyror,masat për mbrojtjen kundër zhurmave, erërave të pakëndeshme dhe zjarrit, si dhe masa të tjera që kanë lidhje me to, që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe përmirësimin e jetës.

| <b>Nr</b> | <b>Kategoria</b>                                     | <b>Njësia</b>    | <b>2025</b> |
|-----------|--|------------------|-------------|
| 1         | Subjekte të nxjerrjes dhe tregtimit të gazit natyror | Lekë/<br>pus/vit | 200 000     |

Subjektet e biznesit të madh që operojnë në territorin në juridiksion të Bashkisë Delvinë por që selinë e tyre e kanë jashtë këtij territori, do të paguajnë të njëjtin nivel tarife me subjektet që e kanë selinë në territorin e Bashkisë. Detyrimi për tarifën do të llogaritet për kohën e kryerjes së aktivitetit.



### B.1.4 TARIFAT PËR FAMILJARËT

| Nr. | Emërtimi i Tarifave   | Njësia   | 2025              |
|-----|---|----------|-------------------|
| 1   | <b>Tarifa e Pastrimit</b>   |          |                   |
|     | a-Njësia Administrative Delvinë.<br>56% e Totalit të Tarifave                 | lekë/vit | <b>900</b>        |
|     | b-Njësia Administrative Vergo dhe fshatrat<br>Varfaj ,Kakodhiq,Leftrehor. 62% | lekë/vit | <b><u>500</u></b> |
| 2   | <b>Tarifa e Ndrçimit</b>  |          |                   |
|     | a-Njësia Administrative Delvine. 30%  | lekë/vit | <b>500</b>        |
|     | b-Njësia Administrative Vergo dhe fshatrat<br>Varfaj ,Kakodhiq,Leftrehor. 25% | lekë/vit | <b><u>200</u></b> |
| 3   | <b>Tarifa e Gjellbërimit</b>  |          |                   |
|     | a-Njësia Administrative Delvine 14%   | lekë/vit | <b>200</b>        |
|     | b-Njësia Administrative Vergo dhe fshatrat<br>Varfaj ,Kakodhiq,Leftrehor. 13% | lekë/vit | <b><u>100</u></b> |

- Njësia Administrative Delvinë **kuota 1 600**  
**lekë/viti**
- Njësia Administrative Vergo dhe fshatrat Varfaj, Kakodhiq, Leftrehor **kuota 800**  
**lekë/viti**

### B.1.5 Përrjashtohen nga Tarifat e Shërbimit Publik.

- Familjet që janë përfituese të ndihmës ekonomike të përjashtohen nga pagesat e tarifave të shërbimit publik për vitin 2025.
- Pensionistët që janë vetëm ose familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë do paguajnë 50% të tarifës.

### B.1.6 Agjentët Tatimorë / Fiskalë.

“Tarifa e shërbimit publik për familjet do të mbliidhet me Agjent Tatimor përkundrejt shpërblimit prej 5 % të shumës së arkëtuar në buxhetin e Bashkisë. Agjenti zgjidhet nga Kryetari i Bashkisë dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak. Marrëdhënia me të rregullohet me kontratë të posaçme.

Agjentët Tatimor të cilët kanë lidhur kontratë me Bashkinë Delvinë për arkëtimin e tarifave të shërbimit publik dhe taksës së ndërtesës për abonentët familjarë janë :

- 1- “UJËSJELLËS KANALIZIME SHA” DELVINË.
- 2- SPIRO PAPA ( për fshatin Leftrehor ).
- 3- MIHAL KICO ( për fshatin Kakodhiq ).

## B.2 TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

|   | <b>Tarifë shërbimi për parkimin e automjeteve</b> | <b>Njësia</b> | <b>2025</b> |
|---|---|---------------|-------------|
| 1 | Autovetura dhe taksi                              | Lekë/vit      | 1 000       |
| 2 | Furgone dhe Mikrobuzë                             |               |             |
|   | a) Transport pasagjerësh                          | Lekë/vit      | 4 000       |
| 3 | Autobuzë  | Lekë/vit      | 7 000       |
| 4 | Automjet transport malli deri 3 ton               | Lekë/vit      | 2 000       |
| 5 | Automjet transport malli mbi 3 ton deti ne 7 ton  | Lekë/vit      | 4 000       |
| 6 | Automjet transport malli mbi 7 ton                | Lekë/vit      | 6 000       |
| 7 | Për parkim të rezervuar                           | Lekë/vit      | 20 000      |

### **B.2.1 TARIFA E PARKIMIT TË AUTOBUZEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK**

Tarifa e Parkimit për subjektin e transportit të udhetarëve ndërqytetas e perfaqësuar nga subjekti “Trans-Sopoti” shpk me nr. NIPT-i L6710150 I , Bashkia Delvinë nuk ka mundësi dhe strukturën e nevojshme që t’i përgjigjet subjektit për hapësire publike për parkim. Si rrjedhim nevoja imediate kërkon që subjekti të kontraktohet me subjekte që i ofrojnë këtë shërbim në tregun e lirë privat.

Per këtë arsye subjekti nuk do të maturohet për tarifën e parkimit nga bashkia .

Kjo është e vlefshme për vitin 2025.

*Struktura e ngarkuar për administrimin e tarifës së parkimit të automjeteve është Njësia e Shërbimeve Komunitare dhe Drejtorisë Taksave dhe Tarifave.*

### **B.3 TARIFA E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE**

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup>, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Kjo tarifë aplikohet për të gjitha bizneset të cilat mund të kryejnë aktivitete të ndryshme me natyrë shërbimi, tregtie etj.

Këshilli Bashkiak vendos nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife. Kjo tarifë nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronesi dhe nën administrim të pushtetit vendor. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

| <b>Zënie e hapësirës publike</b> | <b>Njësia e matjes</b> | <b>2025</b> |
|----------------------------------|------------------------|-------------|
|                                  |                        |             |

|   |                            |    |
|---|----------------------------|----|
| 1- Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi si dhe për zënie të hapësirës publike nga shtyllat elektrike, antenat, kabinat, rrjetet etj. të kësaj natyre duke llogaritur dhe përfshirë gjithë sipërfaqen e objektit. | Lekë /m <sup>2</sup> /muaj | 60 |
| 1/1- Njësia Administrative Vergo dhe fshatrat Varfaj, Kakodhiq, Lefterhor.  | Lekë /m <sup>2</sup> /muaj | 30 |
| 2- Zënia e hapësirës publike për zhvillimin e aktiviteteve tregtare në trotuare.  | Lekë /m <sup>2</sup> /ditë | 60 |

#### **Afati vjeljes së kësaj tarife është gjithë vjetor.**

Detyrimi për tarifen për llogaritjet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelin tregues të saj. Struktura e ngarkuar për evidentimin, regjistrimin, plotësimin e dokumentacionit dhe dhënien e lejës /autorizimin, për zënie të hapësirave publike është **Njësia e Shërbimeve Komunitare**. Njësia e Shërbimeve Komunitare lëshon autorizimin / lejen, pasi konfirmohet pagesa nga Drejtorisë Taksave dhe Tarifave.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifës për zënie të hapësirës publike është Drejtorisë Taksave dhe Tarifave.

Kjo tarifë mund të mblidhet edhe me agjent tatimor të licencuar e të kontraktuar nga Bashkia Delvinë.

Në rastin e mbledhjes së kësaj tarife me agjent tatimor, Keshilli Bashkiak, bazuar në nenin 5 të ligjit Nr 9632 datë 30.10.2006 **“Për Sistemin e Taksave Vendore”** i ndryshuar cakton kufizimet e mëposhteme:

- ✓ *Përlllogaritja e sipërfaqes së zënë me asetet e subjektit dhe maturimi bëhet nga administrat e Bashkisë dhe arkëtimi ndiqet nga agjenti tatimor.*
- ✓ *Agjenti tatimor përgatit bazën ligjore të arkëtimit të këtij detyrimi dhe e mbron këtë arkëtim në organet gjyqësore.*
- ✓ *Agjenti tatimor ka të drejtat dhe detyrimet që parashkruhen në nenin 7 të ligjit Nr 9920 datë 19.05.2008 **“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”** i ndryshuar.*

Agjenti tatimor merr shpërblim për arkëtimet e bëra në llogari të Buxhetit të Bashkisë, jo me shumë se 10% dhe likujdon pranë organeve tatimore, detyrimet fiskale që rrjedhin prej tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**B.4 TARIFA PËR SHËRBIME NË SHTËPINE E KULTURËS, MUZEUT DHE FUSHËS SË SPORTIT.**

| <b>Nr.</b> | <b>Emërtimi i Tarifave</b>   | <b>Njësia</b>       | <b>2025</b> |
|------------|--|---------------------|-------------|
| 1          | Për çdo leje ndërtimi  | Lekë/m <sup>2</sup> | 30          |
| 2          | Tarifë për celje kartele për lexues  | Leke/copa           | 50          |
| 3          | Për lëshim vërtetimi nga arkivi  | Lekë/rast           | 500         |
| 4          | Informacion për zyra avokatie  | Lekë/rast           | 3 500       |
